



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

BE LAJME

qershor 2019
EUC-numër 46/2019



MBLEDHJA E KËSHILLIT PËR ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME TË BE-SË



Përmbajtja e lajmeve:

Mbledhja e Këshillit për Çështje të Përgjithshme të BE-së	1
Aktivitetet pas zgjedhjeve evropiane 2019	2
Zgjedhjet parlamentare në Danimarkë	3
Aktivitetet e Kuvendit lidhur me çështjet evropiane	4-6
Ndryshimet klimatike prioritet në Buxhetin e BE-së për vitin 2020	7
U shënuan 30 vjet „Aktivitetet e Zhan Monesë“	
Tetë qendra evropiane për superkompiutere	8
Gjermania-eksportuesi më i madh i instrumenteve muzikore në BE	8
Prioriteti i mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve	9
25 vjet të Agjencisë Evropiane për Mjedisin Jetësor	9
Tregu Evropian i Mjaltit	10
Rritet prodhimi i plastikës në botë	10
Dita botërore e sigurisë së ushqimit 2019	11
BE kalendar / korrik 2019	11

Këshilli për Çështje të Përgjithshme të Bashkimit Evropian në mbledhjen më 18 qershor sivjet në Luksemburg e riafirmoi angazhimin e vet për zgjerimin që mbetet politika kryesore e BE-së.

Këshilli duke u thirrur në Agjendën e Selanikut dhe Deklaratën e Sofjes, e përsëriti mbështetjen e BE-së për persektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. Bashkimi Evropian është vendosur ta përforsojë dhe intensifikojë angazhimin e vet në të gjitha nivelet për mbështetjen e transformimit politik, ekonomik dhe social të rajonit.

Në pajtim me konkluzionet paraprake të Këshillit dhe në kuadër të kriterëve politike të Kopenhagës dhe procesit të stabilizimit dhe asocimit, Këshilli e konfirmoi nevojën për kushtëzim të drejtë dhe të rreptë dhe parimit të meritave personale.

Në këtë kontekst, Këshilli e theksoi rëndësinë të sigurohet se BE-ja mund ta mbajë dhe thellojë zhvillimin personal duke e përfshirë edhe kapacitetin për integrimin e anëtarëve të rinj.

„Duke pasur parasysh kohën e kufizuar dhe rëndësinë e çështjes, Këshilli do të kthehet në këtë çështje, me qëllim të arrihet vendimi i qartë dhe esencial që është e mundur më shpejt e më së voni deri në tetor 2019“, qëndron në konkluzionet e Këshillit.

Këshilli i konfirmoi njoftimet se vendimi për hapjen e negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë do të anulohet për muajin tetor. BE-ja është e ndarë për vendimin dhe çështja kryesore është nëse BE-ja do të jetë mjaft e vendosur dhe e bashkuar ta përmbush premtimin në muajin tetor dhe të ruajë kredibilitetin e vet në rajon.

Këtë vit Pakoja për zgjerim erdhi më vonë nga e zakonshmja për shkak të zgjedhjeve evropiane që u mbajtën në muajin maj. Edhe pse ekspertët dhe

përfaqësuesit e Brukselit, bashkë me trembëdhjetë vendet-anëtare të BE-së, kërkuar fillimin e negociatave për shkak të shqetësimit se çdo anulim i mëtejme do të mund të shkaktojë ngecje të momentit, kjo përsëri nuk ndodhi.

Mbetet të shihet nëse vendet-anëtare të BE-së do të gjejnë bazë të përbashkët për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë t'i fillojnë negociatat për aderim, meqë disa nga vendet-anëtare, si Gjermania dhe Holanda, kërkuar „ndarjen“ respektivisht vendimmarja për të dyja vendet të jetë veçmas.

Këshilli Evropian në mbledhjen më 20 qershor 2019 i miratoi konkluzionet për procesin e zgjerimit dhe stabilizimit dhe asocimit që ishin paraprakisht të miratuara nga Këshilli për Çështje të Përgjithshme të BE-së, më 18 qershor. Këshilli Evropian e miratoi [Kornizën strategjike të BE-së](#) për periudhën e ardhshme pesëvjeçare 2019-2024. Korniza strategjike vendos katër prioritetet gjithëpërfshirëse të cilat BE-ja do të fokusohet në pesë vitet e ardhshme:

- mbrojtja e qytetarëve dhe lirive,
- zhvillimi i bazës së fuqishme dhe energjetike ekonomike,
- ndërtimi i Evropës klimatike, neutrale, të gjelbër, të drejtë dhe sociale, dhe
- promovimi i interesave dhe vlerave evropiane në skenën globale.

Finlanda nga 1 korriku sivjet do të jetë kryesimi i parë e BE-në e cila do ta përfshijë agjendën e re strategjike pesëvjeçare në punën e Këshillit të BE-së.

www.consilium.europa.eu
www.consilium.europa.eu/media/

AKTIVITETET PAS ZGJEDHJEVE EVROPIANE 2019



www.europarl.europa.eu

Menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve evropiane në vitin 2019 filluan aktivitetet dhe diskutimet për zgjedhjen e presidentit të ri të Komisionit Evropian. Do të ketë gjithashtu nevojë për të zgjedhur një president të ri të Këshillit Evropian, shefin e politikës së jashtme dhe të sigurisë të BE-së, presidentin e Bankës Qendrore Evropiane.

Ende nuk ka vendim të BE-së se kush do ta udhëhiq Komisionin Evropian. Presidenti i ardhshëm i KE-së do të zgjidhet nga një shumicë e kualifikuar të lartë, duke përbërë 72% të vendeve anëtare dhe 65% të popullsisë së BE-së. Presidenti i ri i Komisionit duhet të miratohet nga Parlamenti Evropian. Një çështje aktuale në Bruksel është agjenda e re strategjike e BE-së, d.m.th. qëllimet dhe prioritetet e reja politike për pesë vitet e ardhshme.

Në qershor, anëtarët e rinj të Parlamentit Evropian pas zgjedhjeve i formojnë grupet politike. Mandati i Parlamentit Evropian përfundon zyrtarisht më 1 korrik të këtij viti. Parlamenti i sapozgjedhur mbledhet në seancën plenare inauguruese të 2-4 korrikut dhe zgjedh presidentin e ri të Parlamentit Evropian dhe 14 nënkryetarët, 5 kuestorët dhe do të vendos për numrin e komiteteve të PE-së.



Sesioni i dytë plenar i PE-së nga 15 deri më 18 korrik do të jetë gjithashtu një mundësi për Parlamentin Evropian që të zgjedhë presidentin e ri të Komisionit Evropian. Nëse kandidati nuk e fiton shumicën e kërkuar, vendet anëtare duhet të propozojnë një kandidat tjetër brenda një muaji.

Mandati i presidentit të KE-së, Zhan Klod Junker dhe 27 komisionerëve përfundon më 31 tetor të këtij viti. Më 1 nëntor, Komisioni i ri Evropian do të marrë detyrën. Komisioni Evropian është organ ekzekutiv i BE-së që propozon legjislacionin të ri dhe zbaton legjislacionin. Komisioni është "kujdestar i traktateve", duke siguruar që ato të respektohen nga të gjitha vendet anëtare të BE.

Pas dy mandateve prej dy vjet e gjysmë, presidenca e Donald Tuskut me Këshillin Evropian skadon më 30 nëntor.

European Parliament: 2019-2024

Projection



ZGJEDHJE PARLAMENTARE NË DANIMARKË

Në zgjedhjet parlamentare në Danimarkë të cilat u mbajtën më 5 qershor të këtij viti u zgjodhën 179 anëtarë të rinj në Parlamentin e Danimarkës Folketing. Zgjedhjet u mbajtën dhjetë ditë pas zgjedhjeve për Parlamentin Evropian.

Nga vendet e deputeteve, 175 i referohen Danimarkës dhe nga dy vende të rezervuara për krahinat federale Ishujt Faroe dhe Grenlandi.

Në zgjedhjet fitoi "blloku i kuq" i formuar nga partitë që e dhanë mbështetjen për kandidatin për kryeministër liderja e Socialdemokratëve Mete Frederiksen.

Në përbërjen e bllokut të kuq ishin socialdemokratët, social-liberalët, partia popullore socialiste, aleanca kuq e gjelbër, partia socialdemokrate faroe, të cilët bashkë fituan 91 nga gjithsej 179 vende dhe siguruan shumicë parlamentare.

Koalicioni qeveritar aktual i përbërë nga Venstri, Aleanca liberale dhe Partia popullore konservatore, Partia popullore e Danimarkës dhe Nunata Kitronaj, fituan 76 vende deputetësh.

Më 6 qershor të këtij viti kryeministri Lars Løkke Rasmussen nga Partia liberale qendrore-djathtiste Venstri parashtroi dorëheqje edhe te mbretëresha Margaret II, mundësoi ta emërojë Frederiksen të formojë qeveri të re në Danimarkë. Partia liberale e Rasmussen ishte në pushtet 14 vite.

Danimarka është vendi i tretë skandinav i cili në një vit

zgjodhi qeveri majtiste, pas zgjedhjeve të cilat u mbajtën në Suedi dhe Finlandë.


Kryeministrja e re e Danimarkës 41 vjeçarja Mete Frederiksen pas negociatave tre javore të formojë qeveri me mbështetje nga partitë tjerë të spektrit të majtë.

Frederiksen që në periudhën gjatë fushatës zgjedhore lajmëroi mundësi për formimin e qeverisë pakicë e cila do të bashkëpunojë me bllokun e kuq me të cilin kanë më së shumti tema të përbashkëta, si miratimi i legjislacionit për reduktimin e emisioneve të CO2 për 70% për dekadën e ardhshme.

Si në pjesën tjetër të Evropës, imigrimi ishte çështja kryesore e zgjedhjeve në Danimarkë. Frederiksen zhvilloi fushatë për kontroll të rreptë të refugjatëve dhe azilkërkuesve. Pas reduktimit të shpenzimeve nga qeveria paraprake, socialdemokratët prematuan se do t'i rrisin shpenzimet sociale dhe do të vendosin tatime më të larta te të pasurit.

Mete Frederiksen është kryeministrja e dytë e Danimarkës pas Hall Thorning-Schmidt, gjithashtu socialdemokrat i cili ishte në funksion nga viti 2011 deri në vitin 2015. Shtatë ministra në kabinetin e Frederiksen nga gjithsej 20, janë femra ndër të cilat edhe 38 vjeçja Trine Bratsen e cila udhëheq me resorin e mbrojtjes.

www.bbc.com



AKTIVITETET E KUVENDIT LIDHUR ME ÇËSHTJET EVROPIANE



www.sobranie.mk

Më 22 dhe 23 qershor 2019, në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut u mbajt Dialogu i dytë i Zhan Monesë për Paqe dhe Demokraci - një instrument i zhvilluar nga Parlamenti Evropian si një mjet i pushtetit të butë në sferën e mediacionit dhe dialogut parlamentar i filluar në dhomën historike të Zhan Monesë. Në punën e këtij dialogu morën pjesë aktive Kryetari i Kuvendit, nënkryetarët, koordinatorët e grupeve parlamentare, përfaqësuesit e partive parlamentare në Kuvend dhe shërbimet e Parlamentit, të udhëhequr nga Sekretari i Përgjithshëm i dhomës legjislative. Pjesëmarrësit miratuan konkluzione sipas të cilave kanë një marrëveshje për të vazhduar dialogun për implementimin e agjendës së BE-së të reformave institucionale.



Me pritje solemne më 2 qershor, 2019 Kryetari i Kuvendit Talat Xhaferi e priti Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg dhe Këshillit të Atlantikut të Veriut të NATO-s, i cili udhëhoqi delegacionin prej 29 ambasadorëve nga vendet anëtare të NATO-s në vizitë dy-ditore në vendin tonë. Në pritjen ishin të pranishëm Kryeministri i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, i cili udhëhoqi delegacionin qeveritar dhe përfaqësues të korit diplomatik. Delegacionin e lartë të NATO-s e mirëpritën dhe nënkryetarët e Kuvendit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, koordinatorët e grupeve parlamentare dhe deputetë nga disa parti parlamentare. Me vizitën e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, në godinën e Kuvendit së bashku me flamurin shtetëror tani valon edhe flamuri i NATO-s, ku pritet që Republika e Maqedonisë së Veriut të bëhet shteti i 30-të anëtar.



Gjatë vizitës zyrtare dy-ditore në Konfederatën Zvicerane, delegacioni i udhëhequr nga Kryetari i Kuvendit Talat Xhaferi, më 6 qershor, 2019 u takua me Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Jashtme të Zvicrës, znj. Marty Lang. Gjatë vizitës në nder të Kryetarit Xhaferi, kryetarët e Këshillit Kombëtar dhe Shtetëror mbajtën fjalime përshëndetëse në kuadër të seancës plenare të Parlamentit Zviceran. Delegacioni pati një takim bilateral me Kryetarin e Këshillit Shtetëror, z. Zhan Rene Furnier. Të dy bashkëbiseduesit shprehën gatishmëri për të vazhduar bashkëpunimin intensiv dypalësh. Delegacioni u takua me Kryetaren e Parlamentit Federal të Konfederatës së Zvicrës, znj. Marina Karobio Gusketi, ku Kryetari Xhaferi shprehu bindjen për vazhdimin e bashkëpunimit intensiv bilateral me Konfederatën e Zvicrës dhe Parlamentin e Zvicrës.

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, me ftesë të Kryetarit të Kuvendit Kombëtar të Hungarisë, z. Laslo Kover, më 25 qershor 2019 mori pjesë në aktin e ratifikimit të Protokollit për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO nga Kuvendi Kombëtar i Hungarisë.



Më 11 qershor 2019, Kryetari i Kuvendit Xhaferi mbajti një takim me Kryetarin e Qeverisë së Republikës së Çekisë, Andrej Babis. Xhaferi theksoi se vizita paraqet një mundësi të shkëlqyeshme për thellimin e bashkëpunimit të vendosur dhe realizimin e projekteve konkrete. Të dy bashkëbiseduesit shkëmbyen mendime mbi mundësitë për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik.

AKTIVITETE KUVENDORE NË LIDHJE ME ÇËSHTJET EVROPIANE

Më 13 qershor të vitit 2019 kryetari i Kuvendit z. Talat Xhaferi u takua me deputetët nga Bundestagu gjerman, z. Josip Juratoviq, znj. Renata Allt, z. Hasjerg Miler, të shoqëruar nga ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë z. Tomas Gerberih. Kryetari Xhaferi e theksoi bashkëpunimin parlamentar me Bundestagun, veçanërisht në pjesën e mbindërtimit të kapaciteteve të shërbimit kuvendor. Delegacioni ka realizuar takim me Grupin e deputetëve për bashkëpunim me Parlamentin e Republikës Federale të Gjermanisë, si dhe të Komisioneve për çështje evropiane dhe politikë të jashtme.



Më 20 qershor të vitit 2019 Këshilli Nacional për eurointegritet ka mbajtur Mbledhjen e katërt me temën “Pikëpamjet nga Berlioni dhe Parizi rreth Strategjisë afatgjatë për integritet evropian.” Në mbledhje fjalim kanë mbajtur Sh. T. Tomas Gerberih, ambasador i Republikës Federale Gjermane dhe Sh. T. Kristian Timonie, ambasador i Republikës së Francës. Në mbledhje të pranishëm ishin zëvendës kryetari i Qeverisë i angazhuar për çështje evropiane, z. Bujar Osmani, anëtarët e Komisionit për Çështje Evropiane, të Komisionit për Politikë të Jashtme, Komitetit të Përbashkët Parlamentar RM-BE, përfaqësues të organizatave qytetare si dhe ambasadorë të vendeve anëtare të BE-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni për Çështje Evropiane më 05 qershor të vitit 2019 realizoi takim me Delegacionin e Këshillit për punë evropiane të Saborit të Republikës së Kroacisë në përbërjen: kryetari, nënkryetari dhe anëtar i Këshillit për punë evropiane – Domagoj Ivan Millosheviq, Domagoj Hajdukoviq dhe Vesna Pusi, si dhe kryetari i Këshillit për politikë të jashtme – Miro Kovač në shoqërim të ambasadores kroate, Danijella Barishiq. Në fjalimin përshëndetës, Kryetari i Komisionit për Çështje Evropiane, Artan Grubi theksoi që Republika e Maqedonisë së Veriut tërësisht i ka arritur dhe plotësuar rekomandimet nga BE-ja.



Takim të përbashkët me delegacionin e Saborit kroat kanë pasur Këshilli Nacional për eurointegritet dhe Komisioni për Politikë të Jashtme të Kuvendit. Në takimin nga ana e delegacionit është shprehur gatishmëri për ndarje të përvojave dhe bashkëpunim në procesin euronitegrativ të vendit tonë.



Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, më 12 qershor të vitit 2019 ka realizuar takim me gjeneralin Jeronim Bazo, drejtori i RAKVIAK – Qendra për bashkëpunim sigurie, në të cilin ai është angazhuar për thellim të bashkëpunimit të vendosur me Qendrën rajonale për kontroll dhe verifikim të armatimit dhe ndihmë në implementim. Drejtori Bazo, në mënyrë pozitive i vlerësoi ngjarjet aktuale në shtetin tonë dhe ka shprehur besim në bashkëpunim të mëtejshëm ndërmjet Kuvendit dhe RAKVIAK në të ardhmen.

AKTIVITETE KUVENDORE NË LIDHJE ME ÇËSHTJET EVROPIANE



Deputeti Xhevat Ademi, anëtar i Delegacionit të Kuvendit në Asamblenë parlamentare të Procesit për bashkëpunim në Evropën Juglindore ka marrë pjesë në Sesionin e gjashtë plenar të AP të APEJL, që është mbajtur më 21 dhe 22 qershor të vitit 2019 në Sarajevë, në kuadër të Kryesisë së Bosnje e Hercegovinës me Procesin për bashkëpunim në Evropën Juglindore. Në Sesionin janë mbajtur mbledhje të tre komisioneve dhe e Komitetit të Përhershëm të AP të APEJL, si dhe Seancë Plenare për temën: “Lidhshmëri më e mire për jetë më të mirë – si të arrihet ndryshim i vërtetë në procesin e

Në Kuvend më 26 dhe 27 qershor të vitit 2019 në bashkëpunim me misionin e OSBE në Shkup u mbajt Konferencë Rajonale dy ditore e grave deputete me temën: Parlament senzitiv gjinor: Nga legjislacioni deri në financim publik për barazi gjinore. Konferencën e hapi dhe me atë kryesoi kryetarja e Klubit të grave deputete, Gjylymser Kasapi. Në fjalimin e saj, nënkryetarja e Kuvendit, Frosina Tashevskaja-Remenski, theksoi që pjesëmarrja e barabartë e grave dhe meshkujve në jetën politike dhe publike është e përcaktuar me standardet ndërkombëtare dhe të vendit, që duhet të aplikohen në të gjitha shoqëritë demokratike.



Me ftesë të kryetarit të Parlamentit të Republikës së Austrisë, Volfgang Sobotka, delegacioni i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut i udhëhequr nga nënkryetarja, Frosina Tashevskaja-Remenski, në organizim të OSBE-së në Shkup, nga 5 deri më 7 qershor ka qëndruar në vizitë studimore në Vienë. Delegacioni në përbërjen: nënkryetarët: Goran Misovski dhe Vesel Memedi; koordinatorët e grupeve të deputetëve: Jovan Mitrevski dhe Nikolla Micevski; deputetët: Liljana Kuzmanovska përfaqësuese nga Komisioni për mundësi të barabarta të grave dhe meshkujve, Gjylymser Kasapi, kryetare e Klubit të deputetëve, Mirsada Emini-Asani, Kryetare e Komisionit për shëndetësi, Sekretarja e Përgjithshme, Cvetanka Ivanova, si dhe të punësuar në shërbimin kuvendor, ka realizuar takim me deputet nga Këshilli Nacional austriak, anëtar të Komisionit për trajtim të barabartë i udhëhequr nga kryetarja, Gabriella Hajnisch-Hosek. Me përkrahje të Bashkëpunimit austriak zhvillimor dhe Misionit të Përhershëm të Austrisë në OSBE, në fokusin e vizitës ishin prioritetet kryesore të paraqitura në Planin Strategjik 2019-2020, për fuqizim të pavarësisë parlamentare, funksionin e vet mbikëqyrës dhe rolin demokratik.

Ligje nga NPAA të miratuar në Kuvend më qershor të vitit 2019

	Titulli i ligjit	Kapitulli	Seanca plenare
1	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tarifë doganore	29 UNIONI DOGANOR	Seanca 102, 11.06.2019
2	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për disiplinë financiare	16 TATIMIMI	Seanca 102, 11.06.2019

NDRYSHIMET KLIMATIKE PRIORITET NË BUXHETIN E BE-së PËR VITIN 2020

Komisioni Evropian më 05 qershor të vitit 2019 propozoi buxhet prej 168,3 miliardë euro për vitin 2020 me qëllim të promovimit të ekonomisë më konkurrense evropiane, solidaritet dhe siguri në BE. Ky është buxheti i fundit nga peruidha fiskale 2014-2020 ku ndryshimet klimatike janë vendosur në majë të agjendës.

Buxheti i propozuar prej 168,3 miliardë euro shënon rritje për 1,3% nga viti 2019. Në lidhje me pagesat buxheti është 153,7 miliardë euro ose 3,5% më shumë nga viti i kaluar. Gjithsej, buxheti paraqet 1% të BAN-së së BE-së (bruto të ardhurat nacionale) dhe 2% të konsumit publik të BE-së.

Deri 21% të buxhetit të propozuar do të jetë për çështje në lidhje me ndryshimet klimatike.

Për fuqizim të rritjes ekonomik dhe për mbështetje të të rinjve janë dedikuar 83 miliardë euro, derisa 13,2 miliardë euro do të jenë për hulumtim dhe inovime në kuadër të programit Horizont 2020, që paraqet rritje prej 6,4% në krahasim me buxhetin nga vitit 2019.

Për programin Erasmus për këmbim të studentëve janë planifikuar 2,8 miliardë

euro dhe 117 milionë euro për Iniciativën për punësimin e të rinjve (YEI). Me këtë, Iniciativa për punësimin e të rinjve, është 4,5 miliardë euro për periudhën 2014-2020.

Buxheti për Sistemin global për navigacion global "Galileo" është zmadhuar për 75% në krahasim me vitit 2019 dhe është 1,2 miliard euro. Programi për zhvillim evropian industrial mbrojtës (EDIP) do të fitojë 255 milionë euro.

Në lidhje me fuqizimin e sigurisë dhe solidaritetit në BE dhe më gjerë, 420,6 milionë euro apo 34% më shumë se në vitin 2019, do t'i ndahen Agjencisë evropiane për siguri kufitare – Fronteks. Kjo është rezultat i marrëveshjes së arritur në mars të këtij viti ndërmjet Parlamentit Evropian dhe qeverive të BE-së, me të cilën parashihet formim trupit të përhershëm prej 10.000 rojtarëve të kufijve deri në vitin 2027.

Programi i ri RescEU do të fitojë 156,2 milionë euro, për përmirësim të procesit për ballafaqim me tërmete, zjarre pyjore dhe katastrofa tjera natyrore.



<http://europa.eu>

JANË SHËNUAR 30 VITE "AKTIVITETE ZHAN MONE"

Komisari evropian për arsim, kulturë, të rinj dhe sport, Tibor Navraçiç më 18 qershor ishte nikoqir i ngjarjes me rastin festim i 30 vite "Aktivitete Zhan Mone" që janë pjesë e programit Erasmus+ të përkushtuara në promovim të studimeve evropiane për arsim të lartë në botë dhe lidhje të akademikëve, hulumtuesve dhe krijuesve të politikave.

Nëpërmjet "Aktivitete Zhan Mone", ndërmjet vitit 1989 dhe 2019 janë mbështetur mbi 1.000 universitete në rreth 100 vende, duke u mundësuar t'u ofrojnë kurse për studime evropiane si pjesë e programeve arsimore. Rreth 300.000 studentë i shfrytëzojnë përfitimet nga ky program për çdo vit.

Në nivel vjetor "Aktivitete Zhan Mone"

financojnë më shumë se 250 masa të reja të cilat përfshijnë 9.000 profesorë dhe institucione universitare. Deri më tani janë mbështetur më shumë se 5.000 aksione. "Aktivitete Zhan Mone" janë bërë global, në vitin 2018, 60% prej 1.300 aplikimeve për grante janë nga vendet jashtë BE-së.

Propozimi i Komisionit Evropian për programin Erasmus për vitin 2021-2027 parasheh zgjerim të Aktiviteteve Zhan Mone në sektorë tjerë në arsim, veçanërisht në shkollat me qëllim të përmirësohet vetëdija e të rinjve për BE-në.

<http://europa.eu>



TETË QENDRA EVROPIANE PËR SUPERKOMPJUTERË



Komisioni Evropian më 07 qershor të këtij viti ka njoftuar që është bërë zgjedhja e tetë lokacioneve për qendrat ku do të vendosen superkompjuterët e parë. Qendrat do t'i përkrahin hulumtuesit evropian, industrinë dhe bizneset në zhvillimin e aplikacioneve të reja në spektër të gjerë të fushave, nga dizajnimi i ilaçeve dhe materiale të reja për luftë kundër ndryshimeve klimatike.

Zgjedhja e lokacioneve është bërë nga Shoqata Evropiane për përlogaritje me performanse të larta – EuroHPC.

Të shpërndara janë në 8 vende-anëtare të ndryshme për mirëmbajtje të makinave të reja kompjuterike me performans të lartë, mirëmbajtje të sajteve që gjenden në Sofje (Bullgari), Ostravë (Çeki), Kajaani (Finlandë), Bolonjë (Itali), Bisen (Luksemburg), Minho (Portugali), Maribor (Slloveni) dhe Barselonë (Spanjë). Ato do ta mbështesin zhvillimin e aplikacioneve

kryesore në fushat siç janë mjekësi e personalizuar, dizajn i ilaçeve dhe materialeve, bioinxhiniering, parashikim i kohës dhe ndryshime klimatike.


Në botën e sotme, aftësitë kompjuterike me performans të lartë janë me rëndësi kyçe për gjenerim të rritjes dhe vendeve të punës si dhe për autonomi strategjike dhe inovime në cilëndo fushë.

Superkompjuterët pritet të jenë operativ në gjysmën e dytë të vitit 2020, për shfrytëzuesit evropian prej institucioneve akademike, industrinë dhe sektorin publik.

Me propozim të Komisionit Evropian dhe me përkrahje nga Këshilli i BE-së, kompania e përbashkët EuroHPC është themeluar në nëntor të vitit 2018, me qëllim që BE të pajiset me infrastrukturë për superkompjuterë të klasës botërore deri në fund të vitit 2020.

<http://europa.eu>

GJERMANIA—EKSPORTUESI MË I MADH I INSTRUMENTEVE MUZIKORE NË BE



Vendet-anëtare të BE-së në vitin 2018 kanë realizuar eksport të instrumenteve muzikore në vlerë prej mbi 1,9 miliardë euro, duke përfshirë edhe pjesë dhe shtojca për të njëjtat. Pothuaj 2/3 nga eksporti ka qenë tregti në suaza të BE-së.

Gjermania përfshin 1/3 e eksportit të instrumenteve muzikore në vendet-anëtare të BE-së. Ndërmjet vendeve-anëtare, tre eksportuesit kryesorë kanë qenë Gjermania me 642 milionë euro ose 34% të eksportit të përgjithshëm, Holanda me 310 milionë euro ose 16% dhe Franca me 259 milionë euro apo 14% të eksportit. Italia ka realizuar eksport prej 139 milionë euro, Britania e Madhe 129 milionë euro, (7%) dhe Belgjika 107 milionë euro ose 6%.

Tek eksporti në vende jashtë BE-së (668 milionë euro në vitin 2018), instrumentet muzikore kryesisht janë eksportuar në SHBA (182 milionë euro ose 27% të eksportit të përgjithshëm), pastaj Japoni (91 milionë euro ose 14%), Kinë (88 milionë euro), Zvicër (49 milionë euro), Hong Kong (36 milionë euro), Korea Jugore (32 milionë euro), Norvegjia (28 milionë euro) dhe Rusia (23 milionë euro ose 3% të eksportit të përgjithshëm jashtë BE-së).

Importi i instrumenteve muzikore në BE ka qenë kryesisht nga Kina. Në vitin 2018, vendet-anëtare të BE-së kanë realizuar import të instrumenteve muzikore prej mbi 1,1 miliardë euro nga vende të cilat nuk janë anëtare të BE-së, sikur Kina (453 milionë euro ose 40%), SHBA (220 milionë euro ose 19%), Indonezia (218 milionë euro) dhe Japonia (116 milionë euro ose 10%).

<https://ec.europa.eu>
<https://ec.europa.eu>

PRIORITET I MBROJTJES SHËNDETËSORE TË QYTETARËVE

Listat e gjata të pritjes në shëndetësi janë një nga sfidat më të mëdha me të cilat me dekada ballafaqohen vendet nga Evropa Qendrore dhe Lindore. Për shkak të byrokracisë së ndërlikuar dhe tepër të rregulluar, mungesës së kuadrit të trajnuar dhe pajisjes së nevojshme, pacientët presin në radhë për çfarëdo shërbimi, diagnozë ose trajtim, që mund të nënkuptojë cenim i mundësive për rikuperim të suksesshëm të tyre.

“Secila qeveri duhet prioritet t’i jep mbrojtjes shëndetësore, për shkak se vetëm qytetarë të shëndoshë mund të jenë force shtytëse e rritjes ekonomike” deklaroi Gabriell Grom, nënkryetar i kompanisë farmaceutike MSD për Evropën Qendrore dhe Lindore. Ai sugjeroni që reformat nuk mund të zbatohen në mënyrë universale, duke e pasur parasysh që vendet-anëtare të BE-së kanë nevojat e tyre specifike. Nevojiten korniza të adaptueshme për qasje, si dhe gatishmëri për t’u gjetur zgjidhje në industrinë.

Në fokus të qytetit Zagreb duke pasur parasysh kryesimin e Kroacisë me Këshillin e BE-së nga janari i vitit 2020, janë politikat për transplantim të organeve, sfidat gjatë plakjes dhe siguria e pacientëve. Vëmendje e veçantë do të përkushtohet në onkologjinë, duke pasur parasysh numrin e pacientëve në nivel vjetor. Krijimi i planit në nivel të BE-së në lidhje me kancerin ka qenë edhe ndërmjet prioriteteve të Manfred Veber, kandidati për Partinë Evropiane Popullore (EPP) për kryetar të ri të Komisionit Evropian.

Eurodeputetja Lieve Viernik, në tetor të vitit 2018 deklaroi që kontrollimi i kancerit në Evropë do të kërkon investim të resurseve të konsiderueshme dhe koordinim të politikave nacionale.

www.euractiv.com



25 PREJ FORMIMIT TË AGJENCISË EVROPIANE PËR MJEDIS JETËSOR

Agjencia evropiane për mjedis jetësor me seli në Kopenhagë në Danimarkë, më 19 qershor të këtij viti ka shënuar 25 vite nga formimi. Është mbajtur seminar i veçantë për Këshillin drejtues – trupi më i lartë për vendimmarrje në Agjencinë ku kanë marrë pjesë përfaqësues të lartë dhe ekspertë nga 39 vendeve anëtare dhe vende bashkëpunëtoresh të EEA, të Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian.

Pjesëmarrësit kanë dhënë kontribut për strategjinë dhjetëvjeçare të re për punën e ardhshme të Agjencisë, në sigurim të informatave të pavarura dhe të sigurta për mjedisin jetësor.

Në nder të njëqindvjetorit, agjencia ka përgatitur publikim “EEA në 25” për arritjet dhe sfidat në të ardhmen.

Agjencia evropiane për mjedis jetësor është qendër e diturisë që i lidh botërat

shkencore dhe politike. Agjencia është organizatë rrjeti që bashkon qindra pjesëmarrës agjenci për mjedis jetësor, ministri, administrata publike, organizata hulumtuese – në rrjetin e vet Eionet, që është i vetmi për nga madhësia, vëllimi dhe ekspertiza e vet.

EEA është themeluar në Kopenhagë në vitin 1994, si rrjet prej 12 vendeve të BE-së dhe disa dhjetëra punonjës.

Sot agjencia është zgjeruar në 33 anëtare dhe 6 vende-bashkëpunëtoresh anëmbanë Evropës me personel të lartë që punon në spektër të gjerë të çështjeve.

Raportet e publikuara dhe analiza të EEA bazohen në parashtrimin e rregullt të të dhënave dhe informave prej vendeve-anëtare të BE-së.

www.eea.europa.eu/about-us




TREGU EVROPIAN I MJALTIT

Vendet anëtare të BE-së në vitin 2018 kanë realizuar import të 208,000 ton mjaltë natyral nga vendet jo-anëtare të BE-së, me vlerë prej 452 milion euro. Në vitin 2018, vetëm 21,000 ton mjaltë u eksportuan jashtë BE -së me vlerë 119 milion euro. Krahasuar me vitin 2013, importi i mjaltit jashtë BE-së u rrit me 25%. Nga ana tjetër, eksporti i mjaltit në vendet jo anëtare të BE-së është rritur me 40%.

Bletarët në BE përballen me shpenzime relativisht të larta për prodhim dhe eksportet e kufizuara me çmime më të larta se çmimet e produkteve të importuara në BE. Në anën tjetër, epidemitë e sëmundjeve të kafshëve, bujqësia intensive, ekspozimi ndaj kimikaleve, humbja e habitateve dhe kushteve të pafavorshme klimatike mund të rrezikojë kapacitetet prodhuese të bletarive.

Duke vënë në dukje se numri i kolonive të bletëve në disa vende anëtare të BE-së ka rënë me më shumë se 50%, euro deputetët miratuan Raport më 1 mars këtë vit me çka kërkuan futjen e masave për mbrojtjen dhe për përmirësimin e shëndetit të bletëve si dhe përforcimin e procedurave për testim dhe kontrollet inspektuese për zbulimin e mashtrimeve me mjaltë dhe gjobave më të larta për mashtrim. Bashkimi Europian e përcakton mjaltin si një substancë natyrale të ëmbël dhe ka vendosur kriteret për përbërjen në Direktivën për mjetë bazuar në standarde të larta.

<https://ec.europa.eu>



PRODHIMI I RITUR I PLASTIKËS NË BOTË



Shoqata udhëheqëse pan-evropiane të prodhuesve të plastikës PlasticsEurope në raportin e saj ka theksuar se ka rritje të prodhimit në nivel global nga 3.4% në vitin 2017. Me 359 milion ton të plasuar në treg në vitin 2018, është vërejtur rritje prej 3.2% krahasuar me vitin e kaluar.

Kina është ende në pozitën udhëheqëse në prodhimin e plastikës me 30% në nivel botëror. Së bashku me vendet e tjera në Azi, Kina merr pjesë me më shumë se 50% të prodhimit global të plastikës.

Në Amerikën e Veriut prodhimi i plastikës është rritur në 18% të ndarjes globale.

Prodhimi i plastikës në Evropë shënoi ulje me 4.3% në vitin 2018. Si rezultat i industrisë së paketimit dhe ndërtimit, të cilat janë shumë më përpara nga industria e automobilitave, konsumi i plastikës është rritur me 0.4%.

Në ndarjen e përgjithshme të plastikës së prodhuar përfshin: polietileni (27%), plastika termoreguluese (21%), polipropileni (19%) dhe klorid polivinil ose PVC (13%).

Megjithëse mund të riciklohet lehtë, polietileni tereftalat përfaqëson

www.euractiv.com

DITA BOTËRORE PËR SIGURINË E USHQIMIT 2019

Më 7 qershor të vitit 2019, u shënua Dita e parë botërore e sigurisë së ushqimit 2019 për të tërhequr vëmendjen dhe për të ndihmuar në parandalimin, zbulimin dhe menaxhimin e rreziqeve që lidhen me produktet ushqimore. Organizatat e sigurisë së ushqimore kanë për qëllim në këtë ditë të rrisin vetëdijen globale për sigurinë e ushqimit. Qeveritë duhet të sigurojnë ushqim të sigurt dhe të shëndetshëm për të gjithë. Kreatorët e politikave të promovojnë bujqësinë të qëndrueshme dhe sisteme për ushqim për nxitjen e bashkëpunimit multi-sektorial mes shëndetit publik, shëndetit të kafshëve, bujqësisë dhe sektorëve të tjerë.

Fermerët dhe prodhuesit e ushqimit duhet të miratojnë praktika të mira për furnizim me ushqim të sigurt në nivel global.

Operatorët e biznesit duhet të sigurojnë ushqim të sigurt.

Të gjithë pjesëmarrësit në operacionet ushqimore - nga përpunimi me pakicë - duhet të përputhen me programe të tilla si HACCP.

Të gjithë konsumatorët kanë të drejtë për ushqim të sigurt dhe të shëndetshëm. Konsumatorët kanë nevojë për qasje në informata në kohë, të qarta dhe të besueshme për rreziqe me ushqyerjen dhe sëmundje të lidhura me ushqimin.

Siguria e ushqimit është një përgjegjësi e përbashkët. Nevojitet bashkëpunimi në shumë nivele të qeverisë, trupat ekonomike rajonal, organizatat tregtare, konsumatorët, prodhuesit, institucionet akademike dhe hulumtuese dhe subjektet e sektorit privat në çështjet që prekin të gjithë qytetarët, global, rajonal dhe lokal.

Më 7 qershor të vitit 2019, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e shpalli atë Ditën e Parë Botërore për Siguri të Ushqimit, sipas rezolutës të miratuar në dhjetor të vitit 2018.

www.efsa.europa.eu



BE Kalendar / korrik 2019

1. Kryesia Finlandeze me Këshillin e BE-së në 01 korrik-31 dhjetor 2019;
2. Sesionet plenare të Parlamentit Evropian, 02-04 / 07/2019 dhe 15-18 / 07/2019 në Strasburg;
3. Takimi i Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të BE-së, 27/07/2019.

European Union Newsroom

europa.eu

EUROPA > Newsroom > Calendar

Home | Highlights | Press releases | **Calendar** | Audiovisual | Press contacts | Press facilities | Subscription services | About the EU

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic
Choose a topic

By organiser
Choose an organiser

By type
Choose a type

BY MONTH

July

Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat	Sun
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

Linqe të dobishme për publikime elektronike të BE-së

<https://publications.europa.eu/en/home>

<https://europa.eu/european-union/documents-publications>



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

BE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 Октомври пр. 10, Shkup, 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 55 lokal 414 dhe 289

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

www.sobranie.mk

Në Kuvend ishte zbatuar Projekti IPA Projekt për "Ndihmë Teknike për Parlamentin" në periudhën nga janari 2011 - qershor 2012, qëllimi i të cilit ishte përfundimi i kapaciteteve institucionale të Kuvendit dhe në këtë mënyrë përmirësimi i transparencës dhe përgjegjësisë ndaj qytetarëve.

Në korniza të projektit IPA, ishte siguruar ndihma financiare dhe ndihma profesionale në vendosjen e qendrës së BE-së në Kuvend.

Qëllimi i formimit të Qendrës së BE-së është deputetëve të Kuvendit dhe Shërbimit tu sigurojë qasje më të mirë në informata lidhur me çështjet e BE-së.

Qendra e BE-së është e organizuar në kuadër të Sektorit për Mbështetjen e Këshillit Nacional të Euro Integrimeve.

Qendra e BE-së disponon me bibliotekë të librave dhe publikimeve nga fusha të ndryshme të politikave evropiane.

